



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 19.07.2023)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. (shtyrë nga mbledhjet plenare të datave 22.12.2022, 19.01.2023, 13.02.2023, 6.03.2023, 05.04.2023, 08.05.2023, 06.06.2023, 21.06.2023).

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 1/2023, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 05.04.2023, 08.05.2023, 06.06.2023, 21.06.2023).

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 2/2023, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 05.04.2023, 08.05.2023, 06.06.2023, 21.06.2023).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:11 dhe mbaroi në orën 11:56.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi (zëvendëskryetar)*
- 2. Klodian Kurushi (anëtar)*
- 3. Fatmira Luli (anëtare)*
- 4. Irena Plaku (anëtare)*
- 5. Dritan Hallunaj (anëtar)*
- 6. Ridvan Hado (anëtar)*
- 7. Alban Toro (anëtar)*
- 8. Marçela Shehu (anëtare)*
- 9. Brikena Ukperaj (anëtare)*
- 10. Yllka Rupa (anëtare)*

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami.*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. {...}, {...} dhe {...}, Inspektorë pranë ILD (në sallë).*
- 6. Mimoza Koçiu, përfaqësuese nga ILD.*
- 7. Edlira, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.*
- 8. Klodiana Vogli, Specialiste Ligjore, Ambasada Amerikane.*
- 9. Olta Lolo, eksperte pranë EWMI-INL.*
- 10. Valbona Bala, eksperte pranë EWMI-INL.*

*11. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

*12. Edmond Hoxhaj (BIRN).*

**RENDI I DITËS:**

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. (shtyrë nga mbledhjet plenare të datave 22.12.2022, 19.01.2023, 13.02.2023, 6.03.2023, 05.04.2023, 08.05.2023, 06.06.2023, 21.06.2023).

2. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 1/2023, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 05.04.2023, 08.05.2023, 06.06.2023, 21.06.2023).

3. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 2/2023, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 05.04.2023, 08.05.2023, 06.06.2023, 21.06.2023).

***Ilir Rusi:*** Përshëndetje!

Sipas rendit të ditës, për shkak edhe të krijimit të kuorumit të nevojshëm, deklaroj të hapur këtë mbledhje të ditës së sotme të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sipas rendit të ditës, në tre pikat e para të saj janë zhvillimi i seancave dëgjimore në lidhje me procedimet disiplinore ndaj magjistratit {...}, konkretisht për procedimin disiplinor nr. 3/2022, procedimin disiplinor nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023. Sipas mbledhjes së mëparshme të zhvilluar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor më datë 21 qershor 2023, u përcaktua data 19.07.2023 për zhvillimin e këtyre seancave dëgjimore, për të cilat është njoftuar dhe ka marrë njoftim edhe magjistrati zoti {...}.

Ndërkohë, bëjmë verifikimin e prezencës së palëve.

Sipas autorizimit nr. {...}, datë 18.07.2023 për procedimin disiplinor nr. 3/2022, autorizim i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, autorizohet zonja {...} (prezent), dhe zoti {...} (prezent).

Ndërsa në lidhje me autorizimet e dhëna nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për procedimin disiplinor nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023, zoti {...}, referuar autorizimeve të mëparshme të lëshuara nr. {...}, datë 05.05.2023 dhe nr. {...}, datë 05.05.2023. Zoti {...} prezent.

Ndërkohë, në lidhje me prezencën e z. {...} si magjistrat, më datë 18.07 (me e-mail), të këtij viti, është paraqitur një vërtetim KEMP-i nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër, sipas së cilit ai plotëson kushtet për të fituar invaliditetet plotë për 1 vit, nga 19.06.2023 deri në 30.06.2024, akt i cili është vënë në dispozicion përfaqësuesve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Konfirmoni marrjen dijeni të përmbajtjes së dokumentit?

Faleminderit!

Për më tej, fjalën ia jap relatorit z. Hado.

**Ridvan Hado:** Referuar vërtetimit për sëmundje të përgjithshme, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shkodër, datë 13.07.2023, rezulton se Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shkodër, me vendimin nr. {...}, datë 13.07.2023, ka konkluduar se zoti {...} plotëson kushtet për të fituar të ardhura si invalid i plotë nga data 19.06.2023 deri në 30.06.2024, pasi vuan nga sëmundja çrregullime psiko-regresive. Ka nevojë për përkujdes të vazhdueshëm dhe nuk ka aftësi për punë (pra s' duhet të bëjë asnjë punë).

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Hado!

Para se t'i japim fjalën përfaqësuesve të ILD-së, ndonjë nga anëtarët ka diçka për të thënë në lidhje me këtë proces?

Meqenëse edhe paralelisht, kohë më parë është vendosur edhe zhvillimi i një procesi tjetër administrativ, konkretisht nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës të KLGJ-së. Fjala për kryetarin, z. Kurushi.

**Klodian Kurushi:** Faleminderit z. Rusi.

Në këtë kuadër, për sa kohë bëhet fjalë edhe për një nisje të një verifikimi administrativ nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës mbi bazën e një vendimmarrjeje që mori Këshilli i Lartë Gjyqësor, ne si Komision në verifikimin e aftësisë mendore dhe fizike, referuar nenit 67 të ligjit Për statusin, të magjistratit {...}, kemi hyrë në korrespondencë për të marrë kartelën mjekësore pranë Shërbimit Shëndetësor Mendor Shkodër.

Mbi bazën e kërkesës që kemi bërë, na ka ardhur përgjigjja dhe na është sjellë kartela shëndetësore e shërbimit të psikiatrisë për zotin {...}.

Kjo është pjesë e procedurës së verifikimit. E kemi marrë si akt dhe më tej, së bashku me aktet e tjera, ne do vlerësojmë situatën referuar edhe nenit 67 të ligjit Për statusin.

E çmoj si një detyrim për të informuar mbledhjen, si dhe përfaqësuesit e ILD-së mbi procesin e verifikimit të aftësisë së gjendjes mendore dhe fizike të zotit {...}. Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Kurushi!

Diçka tjetër për të parashtruar nga anëtarët e Këshillit, ka?

Meqenëse nuk ka, fjala është për përfaqësuesit e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me vijimin e këtij procedimi disiplinor.

Fjala për ju zoti {...}!

{...}: Faleminderit!

Atëherë, për rastin në shqyrtim, shikojmë se është e njëjta situatë faktike, siç ka ndodhur edhe në seancën e parë kur ka nisur ky proces. Magjistrati subjekt i procedimit disiplinor nuk është paraqitur për shkaqe shëndetësore. Ndërkohë që, referuar vërtetimit të paraqitur nga Sigurimet Shoqërore, Drejtoria Rajonale Shkodër, vërteton që zoti {...} plotëson kushtet për të fituar të ardhura për invaliditet të plotë nga 19.06.2023 deri më 30.06.2024, që do të thotë që deri më 30.06.2024, z. {...} është i paaftë për të ushtruar funksionin.

Në këto kushte ne i qëndrojmë kërkesave të paraqitura edhe më parë përpara Këshillit, pasi pamundësia objektive për t'u paraqitur në proces nga zoti {...} ka qenë e vazhdueshme dhe për këtë shkak ne kërkojmë sërish që të caktohet një përfaqësues ligjor, referuar nenit 36, pika 3, shkronja "c", e Kodit të Procedurës Administrative.

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti {...}!

Nga përfaqësuesit e tjerë, zonja {...} dhe zoti {...}, ka diçka për të shtuar?

{...}: Po! Plotësisht dakord me kolegun në lidhje me vijimin e mëtejshëm të procedimit disiplinor. S'dua të zgjatem as më shumë as më pak, por duhet të caktohet një përfaqësues, pavarësisht pamundësisë objektive, që të mbrohen interesat dhe të vijojë procedimi disiplinor për magjistratin {...}. Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti {...}!

Ka diçka nga anëtarët?

Ndonjë pyetje?

Atëherë, nisur nga parashtrimet e relatorit z. Hado, dhe parashtrimet e kryetarit të KZHK-së z. Kurushi, nga kërkesat e përfaqësuesve të ILD-së, ju ftoj të tërhiqeni, të largoheni pak, me qëllim që Këshilli të vazhdojë me diskutimet për ecurinë e mëtejshme të këtij procedimi disiplinor, për të tre procedimet disiplinore.

*(Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së. Gjithashtu shkëputet edhe lidhja me pjesëmarrësit në platformën "online", për të vijuar diskutimi vetëm midis anëtarëve të Këshillit. Pas diskutimit, ftohen të futen në sallën e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së. Gjithashtu mundësohet edhe lidhja nëpërmjet platformës për pjesëmarrësit "online".)*

**Ilir Rusi:** Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar aktit të datës 13.07.2023 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër, të paraqitur lidhur me magjistratin z. {...}, sipas së cilit me vendimin nr. 452, datë 13.07.2023 cakton se zoti {...} plotëson kushtet për të fituar të ardhura për invaliditet të plotë nga data 19.06.2023, deri në datën

30.06.2024 sepse vuan nga sëmundja “Psiko-regresive” dhe ka nevojë për përkujdesje dhe verifikimi i gjendjes së tij do të bëhet në maj të vitit 2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 116 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, dhe nenit 44 të Kodit të Procedurës Penale, vendosi:

Pezullimin e të tria procedimeve disiplinore për një periudhë 1-vjeçare (procedimin disiplinor nr. 3/2022, procedimin disiplinor nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023).

Ju faleminderit!

*(Largohen nga salla e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së.)*

\* \* \*

(Pikat 1, 2, 3 të rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 19.07.2023)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017–2019, relator z. Ridvan Hado.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:11 dhe mbaroi në orën 11:56.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Yllka Rupa</b>     | <b>(anëtare)</b>         |



**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Edlira, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.**
- 6. Klodiana Vogli, Specialiste Ligjore, Ambasada Amerikane.**
- 7. Olta Lolo, eksperte pranë EWMI-INL.**
- 8. Valbona Bala, eksperte pranë EWMI-INL.**
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 10. Edmond Hoxhaj (BIRN).**

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017 – 2019, relator z. Ridvan Hado.

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë me pikën katër, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017 – 2019, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës. Relator z. Hado.

**Ridvna Hado:** Faleminderit!

Procedura e vlerësimit të gjyqtares {...} ka filluar me vendimin e Këshillit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 371, datë 13.09.2022, për periudhën e vlerësimit 2017 – 2019, sipas programit të vlerësimeve për vitin 2021.

Pas shortit jam përzgjedhur unë si relator, ndërsa nëpunësja përgjegjëse për vlerësimin, zonja Esmerilda Habili. Procedura është bërë e plotë.

Po kaloj në mënyrë të përmbledhur analizën e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit dhe propozimin për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi.

Për kriterin e parë “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, nënkriteri 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për përshkrimin dhe analizën e fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen në trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë koncize, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e saj. Sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtares lidhur me këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit material dhe procedural në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter civil apo penal. Evidentohet një kujdes i gjyqtares për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor. Sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtares lidhur me këtë tregues është shumë e lartë, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.B. Arsyetimi ligjor, 1.B.a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për

lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nëndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes. Vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës lidhur me këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

#### 1.B.b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të organizuar të vendimit, të ndarë në tituj dhe gjithmonë mendimi është ndarë në paragrafë të numërtuar. Gjyqtarja ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuara kryesisht nga gjykata, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të cilat janë pjesë e rrethanave të faktit, ligjin e zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata. Konstatohet që për çdo nëndarje apo njësi të vendimit të jenë vendosur titujt përkatës dhe fjali tematike, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave superiore mbi përmbajtjen e vendimit si dhe në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij duke mundësuar përgjithësisht lexim të organizuar dhe të strukturuar në rrjedhë logjike. Sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarës në këtë tregues është shumë e lartë duke u pikëzuar me 10 pikë.

#### 1.B.c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke i vlerësuar tërësinë e tyre në raport me natyrën e çështjeve, komplekse ose jo, rezulton se gjyqtarja ka aftësi të larta në lidhje me këtë tregues. Konstatohet se vendimet gjyqësore burim vlerësimi, në varësi të kompleksitetit të çështjes dhe pretendimet e palëve, në pjesën analitike të tyre përmbajnë argumente të lidhura me njëri-tjetrin, duke u ndalur tek evidentimi i lidhjes shkak-pasojë në raport me konkluzionet për zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja i kushton rëndësi analizimit të pretendimeve të palëve në raport me rrethanat konkrete të çështjes, duke i dhënë përgjigje të argumentuar si për çështjet e procedurës ashtu dhe ato për themelin e çështjes. Përgjithësisht, arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe atë material,

me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin e parë “Aftësitë profesionale të gjyqtarës” është 100 pikë dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Kriteri i dytë “Aftësitë organizative të gjyqtarit”. 2.A. Aftësia e gjyqtarës për të përballuar ngarkesën në punë – 2.A.a. Respektimi i afateve ligjore.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përlllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, përjashtohen çështjet ku afati ligjor është tejkalluar me një kohë relativisht të shkurtër (deri në 2 ditë), atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 7 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor, me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (102 çështje), rezulton të jetë 6.8 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor, përqindje që sipas metodologjisë vlerësohet me 15 pikë, pasi është brenda marzhit 0-10%. Vlerësohet pra se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet me 15 pikë.

2.A.b. Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve që rezulton 7 %, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë. Sa më sipër, vlerësoj se në lidhje me këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi 7% i çështjeve jashtë standardit minimal kohor, përfshihet në nivelin maksimal të vlerësimit, nga 0 – 10%.

2.A.c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Referuar metodologjisë, duke qenë se shumicën e kategorive të çështjeve (9 nga 10 kategori), koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, përveç kategorisë “Familjare pa palë

kundërshtare”, ku standardi minimal kohor është tejkaluar me vetëm 11.5 ditë, çka vlerësohet tejkalim i papërfillshëm, gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues. Sa më sipër vlerësoj se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje duhet të konsiderohet më e shkurtër me standardin minimal kohor për të gjithë kategoritë e çështjeve, duke u pikëzuar me 5 pikë.

#### 2.A.ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 116.7 %, e për këtë arsye gjyqtarja duhet të vlerësohet dhe pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues, pasi rezulton me një rendiment mbi 99 %. Pra aftësia e gjyqtarës për këtë tregues duhet të pikëzohet me 10 pikë, pasi rezulton me një rendiment mbi 99%.

#### 2.A.d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar.

Referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve” dhe gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues. Gjyqtarja duhet të vlerësohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

#### 2.B. Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2,9 seanca dhe në çdo rast gjyqtarja ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave. Shkalla e aftësisë duhet të vlerësohet në nivel maksimal, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet

procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjyqimit në kohë duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse. Sa më sipër vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë dhe propozojmë pikëzimin me 20 pikë.

2.C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik (sipas kategorisë) dhe kronologjike (brenda së njëjtës kategori aktesh), është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi. Sa më sipër vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë duke u pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë mbi mesataren për këtë tregues, pasi në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete apo mungesa të akteve që lidhen me çështjen konkrete, përveç mungesës të “Letrës të të drejtave” e cila nuk rezulton të jetë administruar bashkëlidhur kopjes së njoftimeve për seancën e parë gjyqësore për të pandehurin dhe të dëmtuarin nga vepra penale në dosjet penale të përzgjedhura me short për vlerësim. Sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues duhet të vlerësohet “mbi mesatare” duke u pikëzuar me 8 pikë (nga 10 të mundshme).

Nga ana e gjyqtarës për këtë tregues është bërë kundërshtim, duke pretenduar se letra e të drejtave bëhet vetëm në një kopje dhe s’mund të jetë në dosje. I qëndroj propozimit që sapo thashë, me argumentimin se pavarësisht se letra e të drejtave në procesin penal është një kopje, aktin e njoftimit për seancën gjyqësore, duhet shënuar që bashkëlidhur dërgohet edhe letra e të drejtave. Në këto kushte i qëndroj këtij propozimi për vlerësimin.

Për kriterin e dytë, propozimi për nivelin e vlerësimit për “Aftësitë organizative të gjyqtarës” është 98 pikë, dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Kalojmë tek kriteri i tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

3.A. Etika në punë.

### 3.A.a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion. Sa më sipër vlerësoj se duhet vlerësuar shumë lart, duke u pikëzuar me 35 pikë.

### 3.B. Integriteti i gjyqtares.

#### 3.B.a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësohet se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit. Pra vlerësoj që për këtë tregues vlerësimi është shumë i lartë dhe duhet të pikëzohet me 40 pikë.

### 3.C. Paanësia e gjyqtarit.

#### 3.C.a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese dhe propozohet për t'u pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është "I pakonsiderueshëm", duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për përjashtimin e saj. Sa më sipër vlerësoj se ky numër është i pakonsiderueshëm, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Propozimi për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është 100 pikë dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Kalojmë tek kriteri i katërt “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”.

4.A. Aftësitë e komunikimit.

4.A.a. Komunikimi i qartë dhe transparent.

Nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme. Sa më sipër vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares lidhur me këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka respektuar konfidencialitetin dhe të dhënat personale të palëve duke treguar aftësi të larta në drejtim të këtij treguesi. Sa më sipër vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares lidhur me këtë tregues është e lartë, duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B. Aftësitë për të bashkëpunuar.

4.B.a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë. Sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares lidhur me këtë tregues është shumë e lartë dhe propozoj pikëzimin me 15 pikë.

4.B.b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë. Prandaj vlerësoj se për këtë tregues shkalla e aftësisë së gjyqtares është shumë e lartë dhe propozoj pikëzimin me 10 pikë.

4.C. Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a. Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.



Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 17 aktivitete të zhvilluara për 32 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën trevjeçare. Sa më sipër vlerësoj se pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitete trajnuese të Shkollës së Magjistraturës është brenda marzhit 15-120 ditë, duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk është angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësuese apo eksperte pranë Shkollës së Magjistraturës. Sa më sipër vlerësoj se lidhur me këtë tregues nuk rezulton angazhim i gjyqtares, për pasojë duhet të pikëzohet me 3 pikë.

4.C.c. Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndër instucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera. Sa më sipër vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me 3 pikë.

4.C.ç. Publikimet ligjore akademike.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Propozimi për nivelin e kriterit të katërt “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, pikët 96, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe niveli i përgjithshëm i vlerësimit:

Për kriterin e parë “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Për kriterin e dytë “Aftësitë organizative të gjyqtares”, pikët 98, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Për kriterin e katërt “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, pikët 96, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit:

Vlerësimi i përgjithshëm, 394 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Hado!

Ka diskutime për sa u parashtrua nga relatori?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime, atëherë vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Duke vlerësuar punën e relatorit, pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord. *(Vota e zotit Toro nuk dëgjohet në audio, por i kontaktuar nëpërmjet e-mailit ka konfirmuar votën “dakord”. Për efekt të procesverbalit e-maili i konfirmimit të votës i bashkëlidhet procesverbalit të siglosur.)*

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017 – 2019”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017 – 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 19.07.2023)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...} për vitin 2022”, relatore znj. Brikena Ukperaj.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:11 dhe mbaroi në orën 11:56.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                                 |
|---------------------------|---------------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>10. Yllka Rupa</b>     | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Vjollca Kola, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Edlira, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.**
- 6. Klodiana Vogli, Specialiste Ligjore, Ambasada Amerikane.**
- 7. Olta Lolo, eksperte pranë EWMI-INL.**
- 8. Valbona Bala, eksperte pranë EWMI-INL.**
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 10. Edmond Hoxhaj (BIRN).**

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...} për vitin 2022”, relatore *znj. Brikena Ukperaj*.

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë me pikën 5 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2022, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës. Fjala për relatoren *znj. Ukperaj*.

**Brikena Ukperaj:** Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Gjyqtarja {...} është vlerësuar me procedurë të përshpejtuar për vitin kalendarik 2022, pasi ajo është kualifikuar në listën e gjyqtarëve që mund të kenë dy vlerësime për efekt të procedurave të lëvizjes paralele.

Projektraporti i vlerësimit dhe raporti analitik i janë njoftuar gjyqtarës në adresën e saj elektronike. Gjyqtarja ka marrë dijeni dhe është shprehur se nuk ka kundërshtime lidhur me propozimet e relatorit, nuk ka prova të reja për të paraqitur dhe nuk ka kërkuar që të marrë pjesë në seancë dëgjimore.

Në vijim po paraqes në mënyrë sintetike rezultatet dhe propozimet e mia për secilin nga treguesit e katër kriterëve të vlerësimit.

Lidhur me “Aftësitë profesionale të gjyqtarës”, për sa i përket 1.A.a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, shkalla e aftësisë së gjyqtarës rezulton shumë e lartë, pikëzimi 25 pikë, pasi rezulton se ajo ka aftësi shumë të mira për identifikimin për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe përshkrimin e tyre duke i ndërthurur me provat e administruara në gjykim. Aftësi shumë të lartë në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Për sa i përket 1.A.b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, propozohet shkallë shumë e lartë aftësie, pikëzimi 25 pikë, pasi në të gjitha vendimet përfundimtare, interpretimi nëpërmjet zërthimit të kuptimit e qëllimit të elementëve të dispozitave ligjore, para zbatimit të tyre para aplikimit mbi faktet konkrete, pasurohet me referimin në praktikën unifikuese/njehsuese të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese. Zënë një peshë të konsiderueshme në arsyetimin e vendimeve, i mbështetur gjithmonë në parimet e përgjithshme të së drejtës. Në ato raste kur disponimet e gjykatës lidhen me fazën e kërkesave të hetimit paraprak ose dërgimin e çështjes në gjyq, interpretimi abstrakt i dispozitave ligjore edhe pse më i kufizuar, është në masën e duhur të diktuar nga lënda objekt shqyrtimi.

Për sa i përket 1.B.a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit, propozohet shkallë shumë e lartë e aftësisë, pikëzimi 15 pikë, pasi rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në drejtim të këtij drejtuesi.

Për sa i përket 1.B.b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit është propozuar shkallë aftësie mbi mesatare, 8 pikë, për arsye sepse nga burimet

rezulton se ajo ka një strukturë të mirëorganizuar në aspektin vizual, me përjashtim të dy vendimeve gjyqësore ku nuk pasqyrohen në pjesën e parë të dhënat mbi viktimën si subjekt procedimi penal, ndërkohë që në drejtim të përmbajtjes, struktura e vendimit është e ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, por në asnjë rast nuk evidentohet masa e shpenzimeve gjyqësore, çka e bën të paqartë masën e detyrimit për palën që ato i ngarkohen. Për këtë arsye, në strukturimin e vendimit për pjesën e parë dhe pjesën e fundit (dispozitivin e vendimit) është propozuar shkallë aftësie “mbi mesatare”, pikëzimi me 8 pikë.

Për sa i përket treguesit të fundit të kriterit të parë, propozohet shkallë shumë e lartë aftësie, pikëzimi 25 pikë, pasi cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të vetë zhvillimit të mendimit juridik të gjyqtarës në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Ka vijueshmëri mendimi logjik dhe spikat interpretimi individual i ligjit, si dhe është analizë e plotë, e qartë dhe gjithëpërfshirëse e pretendimeve të palëve.

Përfundimisht, për kriterin e parë propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm" dhe pikët 98.

Për sa i përket kriterit të dytë “Aftësia organizative” 2.A.a. Respektimi i afateve ligjore ka rezultuar vetëm 6% e çështjeve jashtë afatit ligjor. Ka pasur në fakt nga 68 çështje që parashikojnë afat ligjor, vetëm 4 të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, për këtë arsye, referuar metodologjisë, pikëzimi është me 15 pikë, pa qenë e nevojshme t'i nënshtrohet analizës logjike të të dhënave statistikore.

Për sa i përket 2.A.b. Plotësimi i standardeve minimale kohore, ka rezultuar vetëm 10.4% e çështjeve në tejkalim të këtij standardi. Ka gjykuar në total 212 çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, nga të cilat 29 çështje janë jashtë këtij afati dhe për këtë arsye, referuar metodologjisë është pikëzuar me 5 pikë.

Për sa i përket 2.A.c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, ka rezultuar më e shkurtër se standardi për 10 nga kategoritë (ka shprehje të audios) ... pra më e gjatë se standardi. Kategoria është për çështjet familjare pa palë kundërshtarë ku rezultojnë të jenë gjykuar jashtë standardit 3 çështje, 2 nga të cilat kanë pasur për objekt “Miratim familje kujdestare”, gjykim për të cilin edhe pse nuk ka afate ligjore shqyrtimi, natyra e

çështjes kërkon kujdes të shtuar nga ana e gjyqtarës për ta gjykuar në një kohë sa më të shpejtë. Këto dy çështje janë gjykuar respektivisht për 183 dhe 181 ditë dhe vetëm për njërën prej tyre rezultoi të ketë ndikuar periudha e lejes vjetore, e cila edhe nëse do të zbritej, përsëri çështja rezultoi e shqyrtuar jashtë afatit standard. Nga ana tjetër ngarkesa në punë e gjyqtarës (në analizë logjike të të dhënave statistikore) në total 315 çështje në gjykim në vitin 2022 (43 çështje të mbartura nga viti 2021 dhe 272 çështje të marra rishtazi në gjykim për vitin 2022), nga të cilat 112 çështje pa palë kundërshtarë, nuk justifikon zbatimin e një shkalle më të lartë pikëzimi se ajo që rezultoi nga analiza matematikore. Për këtë arsye kam propozuar që për këtë tregues gjyqtarja të pikëzohet me 4 pikë.

Sa i përket “Rendimentit”, ka rezultuar +99% (103%), pikëzimi me 10 pikë.

2.A.d. Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor është më shkurtër ose e barabartë për të gjitha kategoritë e çështjeve. Pikëzimi 15 pikë.

Për sa i përket 2.B.a. Numri mesatar i seancave gjyqësore [...] për shmangien e seancave joproduktive, ka rezultuar që numri mesatar i seancave të jetë vetëm 1 dhe rrjedhimisht pikëzohet me 15 pikë. Nuk ka asnjë seancë nga dosjet e shqyrtuara joefektive të zhvilluara.

Për sa i përket 2.B.b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor ka rezultuar nga të dhënat e burimeve të vlerësimit se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie për këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur në përgjithësi me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të vëzhguara. Pikëzimi me 20 pikë.

Për sa i përket 2.C.a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes dhe 2.C.b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes, propozohet pikëzim maksimal për të dy treguesit, pasi renditja e akteve e bën të lehtë shfrytëzimin e dosjes dhe njëkohësisht janë të përfshira të gjitha aktet procedurale dhe nuk evidentohet prania e akteve që nuk i përkasin çështjeve në shqyrtim.

Përfundimisht për kriterin e “Aftësive organizative” propozohet niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 99.



Për sa i përket “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”: 3.A.a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion, burimi kryesor i vlerësimit kanë qenë ankesat e trajtuara nga ILD, ku asnjëra prej tyre nuk evidentohet për t’u marrë parasysh për efekt të vlerësimit etik dhe profesional. Janë ankesa që lidhen kryesisht me mënyrën e vlerësimit të çështjes nga ana e gjyqtarës dhe janë çështje që shqyrtohen nga gjykatat më të larta. Të gjitha ankesat janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar të tyre nga ana e ILD-së. Nuk ka të dhëna për masa disiplinore. Nuk ka të dhëna për sjellje në kundërshtim me rregullat e etikës gjyqësore. Debati gjyqësor në procesverbalet e dëgjuara, është drejtuar duke përdorur fjalë dhe shprehje brenda etikës dhe dinjitetit të palëve. Për këtë arsye është propozuar shkallë shumë e lartë aftësie, 35 pikë.

Për sa i përket 3.B.a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti, nga burimet e vlerësimit, përfshirë edhe raportin e ILDKPKI-së që nuk ka konstatuar konflikt interesi, nuk evidentohen të dhëna që mund të çonin në ndryshim të parimit të prezumimit sipas së cilit gjyqtari për shkak të statusit të tij gëzon integritet dhe shmang shfaqjen e sjelljeve të pahijshme të nderit dhe të dinjitetit. Për këtë arsye është pikëzuar me 40 pikë.

Nuk ka të dhëna për përdorimin e gjuhës diskriminuese në përpilimin e akteve dhe dokumenteve të vëzhguara. Është propozuar pikëzimi me 10 pikë.

Janë paraqitur 8 kërkesa për përjashtim, të cilat të gjitha janë rrëzuar. Në këtë kuadër, numri i kërkesave të palëve të pranuar për përjashtimin e gjyqtarës është i pakonsiderueshëm.

Përfundimisht, për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Pikët 100.

Për sa i përket treguesve të kriterit të katërt që kanë të bëjnë me “Aftësitë personale të gjyqtarit”, 4.A.a. Komunikimi i qartë dhe transparent, 4.A.b. Respektimi i konfidencialitetit, 4.B.a. Shkalla e bashkëpunimit me kolegët dhe 4.B.b. me administratën gjyqësore, është propozuar në shkallë shumë të lartë aftësie, (25, 15, 15, 10 pikë). Nga të dhënat e burimit nuk ka të dhëna të tjera që mund të afektojnë aftësinë e gjyqtarës lidhur me këta tregues.

Për sa i përket 4.C.a. Pjesëmarrjes së gjyqtarës në programet e formimit vazhdues,

gjqqtarja ka marrë pjesë në 12 aktivitete trajnuese të shtrira në 15 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimalë (5 deri në 40 ditë në vit). Pikëzimi me 20 pikë.

Për sa i përket 4.C.b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë dhe 4.C.c. Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale, nuk ka të dhëna për kontribut efektiv të gjyqtares, për këtë arsye për këta dy tregues është vlerësuar me nga 3 pikë.

Ndërkohë që nuk rezultojnë të dhëna për 4.C.ç. Publikimet ligjore akademike. Pikëzimi me 0 pikë.

Përfundimisht, për kriterin e katërt propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Pikët 91.

Përfundimisht, për katër kriteret e vlerësimit, propozimi është:

“Aftësitë profesionale të gjyqtares”, 98, "Shkëlqyeshëm".

“Aftësitë organizative të gjyqtares”, 99, "Shkëlqyeshëm".

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, 100, "Shkëlqyeshëm”.

“Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, 91, "Shkëlqyeshëm".

Në tërësi, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Pikët 388.

Në përfundim të projektraportit të vlerësimit janë dhënë edhe propozimet edhe rekomandimet që kanë të bëjnë kryesisht me nxitjen e kontributeve të gjyqtares për zhvillimin e aftësive të saj personale dhe angazhimit profesional.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime nga anëtarët?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

***Irena Plaku:*** Pro.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2022”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2022”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 19.07.2023)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi). (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 27.06.2023).

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:11 dhe mbaroi në orën 11:56.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Yllka Rupa</b>     | <b>(anëtare)</b>         |

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Edlira, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.**
- 6. Klodiana Vogli, Specialiste Ligjore, Ambasada Amerikane.**
- 7. Olta Lolo, eksperte pranë EWMI-INL.**
- 8. Valbona Bala, eksperte pranë EWMI-INL.**
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 10. Edmond Hoxhaj (BIRN).**

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi). (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 27.06.2023).

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë me pikën 6 të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit, z. Kurushi.

**Klodian Kurushi:** Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Në lidhje me pjesën e pikës 6 të mbledhjes që i referohet rendit të ditës sot, si relator i çështjes, më duhet të parashtoj përpara Këshillit se nuk kemi ndryshime në lidhje me relacionin që kemi bërë në prezantim në mbledhjen e fundit “Për miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”.

Më duhet t’ju vë në dijeni se në mbledhjen e fundit zonja Ukperaj kërkoi kohë për t’u njohur me materialin e çështjes dhe ajo mbledhje është ndërprerë pikërisht në këtë fazë me kërkesë të zonjës Ukperaj.

Unë vetë nuk kam gjë për të shtuar nga relacioni që kam prezantuar në mbledhjen e fundit.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Kurushi!

Për më tej fjalën zonja Ukperaj.

***Brikena Ukperaj:*** Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Pasi kam parë draftin e përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, draftin e rregullave që na është përcjellë nga Gjykata e Lartë, midis të cilave na u vunë në dispozicion edhe komentet e z. {...} si anëtar i Gjykatës së Lartë, lidhur me rregulloren, kam përgatitur disa ndryshime që në fakt thelbësore është vetëm një, lidhur me mënyrën e verifikimit të kriterëve të kandidatëve, ndërsa pjesa tjetër është më tepër sistemim i teknikës legjislative.

Në draftin e përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në fakt na paraqitet herë si rregullore dhe herë si vendim, por duke marrë parasysh që rregullorja ka karakterin e akteve të brendshme institucionale, mendoj që projekt-akti duhet të dalë në formën e një projektvendimi, titulli i të cilit të jetë pikërisht ai parashikim ligjor për të cilën ne kemi rezervë ligjore të miratojmë projektvendimin, pra “Rregulla për procedurat e mbledhjes së përgjithshme, votimin dhe mënyrën e numërimit të rezultatit të votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë”. Ky është tekstualisht parashikim i ligjit dhe mendoj që duhet të dalë në formën e një projektvendimi dhe jo rregulloreje.

Nëse do të pranohet ky version pra që do të kemi një projektvendim dhe rregullore, pastaj në shumicën e dispozitave, ndryshimi është thjesht, është hequr

“objekti i rregullores” është bërë “objekti i këtij vendimi”, pra është hequr fjala “rregullore”.

Tek neni 1 është hequr vetëm fjala “rregullore” dhe është lënë “objekti”.

Tek neni 2 unë vlerësoj që baza ligjore nuk është e nevojshme për të qëndruar në një akt nënligjor për arsye sepse është preambula për përcakton bazën ligjore mbi bazën e të cilit del akti. Neni 2 kam propozuar që të zëvendësohet me “Përkufizime”.

Pse është e nevojshme që të bëhet një përkufizim i termit “mbledhja e përgjithshme”? Sepse mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në fakt në përbërje të saj varion për shkak të lëndës që merr në shqyrtim sepse në rastin kur zgjidhet Zëvendëskryetari, mbledhja e përgjithshme e Gjykatës së Lartë përbëhet edhe nga ndihmësmagjistratët. Në rastin kur zgjidhet Kryetari, mbledhja e përgjithshme e Gjykatës së Lartë përbëhet vetëm nga trupa gjyqësore. Prandaj, për të mos rënë edhe në përsëritje në dispozitat e mëtejshme dhe të themi “mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, kam menduar që duhet të ketë një përkufizim se kush është mbledhja e përgjithshme për efekt të këtij vendimi, është mbledhja e të gjithë anëtarëve të emëruar gjyqtarë në Gjykatën e Lartë sipas dispozitave të ligjit “Për statusin”.

Për sa i përket nenit 3, është hequr vetëm fjala “mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” sepse në kushtet kur ne konkludojmë për një përkufizim të termit, tani do të kemi term të unifikuar në të gjithë draft aktin.

Për sa i përket nenit 4, kam vlerësuar që të shtohet pika 2 sepse mund të ndodhë që objektivisht, Kryetari apo Zëvendëskryetari nuk janë të mundur për të drejtuar dhe thirrur mbledhjen. E kemi bërë edhe në akte të tjera. Në këtë rast mbledhja thirret dhe drejtohet nga gjyqtari me përvojën më të gjatë profesionale si magjistrat në profilin gjyqtar.

Për sa i përket nenit 5. Neni 5 i janë shtuar dy pika, pika 2 dhe pika 3. Pika 2 dhe pika 3 kanë të bëjnë me parashikimet shprehimisht të paraqitjes veç kërkesës me shkrim dhe të dokumentacionit provues nga kandidatët që shfaqin interes për t’u zgjedhur si kryetarë të Gjykatës së Lartë. Është i nevojshëm paraqitja e dokumentacionit provues sepse siç do ta shikoni edhe në vijim pastaj të propozimeve të mia, të gjitha këto materiale duhet t’iu vihen në dispozicion anëtarëve të Gjykatës së Lartë para votimit, goftë edhe platforma personale e secilit kandidat. Pika 3 ka të bëjë më tepër me

dokumentimin e dokumentacionit ku kam parashikuar që aktet, pra gjithë kërkesa me shkrim e dokumentacionit provues të përmbushjes së kriterëve ligjore të kandidimit nga secili nga kandidatët, protokollohet në regjistrin e posaçëm që mbahet për këtë qëllim, i cili në fund të procesit arkivohet bashkë me aktet e kësaj procedure. Pra është më tepër për qëllim dokumentimi (për të qenë më të qartë).

Për sa i përket nenit 6 “Caktimi i ditës së zhvillimit të mbledhjes plenare”, në fakt është më tepër saktësim, duhet të caktojë datën, ditën dhe orën e zhvillimit (thjesht saktësim gjuhësor). Është hequr pika 2 sepse nuk ka lidhje me nenin (“kandidatët duhet të paraqesin përpara mbledhjes plenare platformën e tyre”). E thamë më përpara që e paraqesin platformën bashkë me dokumentet, njëkohësisht e kam parashikuar më pas në momentin kur parashikohet mënyra e zhvillimit të mbledhjes plenare, ku secili nga kandidatët e paraqet edhe në mënyrë verbale platformën e tij personale. Pra është hequr pika 2.

Për sa i përket nenit 7 “Thirrja e mbledhjes së përgjithshme”, është hequr fjala “Gjykatës së Lartë”, duke mbajtur në vëmendje që tashmë kemi termin e unifikuar “mbledhje e përgjithshme”; dhe është shtuar pjesa që “Kryetari i Gjykatës së Lartë njofton thirrjen e mbledhjes së përgjithshme dhe shpërndan listën e kandidatëve që kanë shfaqur interesin për kryetar dhe dokumentacionin e depozituar prej tyre”. Pra çdo kandidat, përveç shfaqjes së interesit, duhet të depozitojë edhe dokumentacionin për kriteret që kërkon ligji për t’u zgjedhur si kryetar.

Pika 8 është “Përgatitja e mbledhjes së përgjithshme”, është shtuar “njoftimin e gjyqtarëve për ditën, datën dhe orën e mbledhjes”, për të qenë në të njëjtin uniformitet me parashikimet e nenit të mësipërm.

Për sa i përket nenit 9, neni 10 dhe neni 11, thjesht ka zhvendosje për të ndjekur në rend kronologjik hapat e mbledhjes.

Neni 9, nga ana e Komisionit është “Verifikimi i kriterëve për kandidatët”. Unë kam vlerësuar që duhet të jetë në fakt neni 10 në vend të nenit 9. Nuk ka ndryshim fare në formulim. Vetëm se në nenin 10, tek rregullorja është në pikën 2, në fakt duhej pika 1. E kam specifikuar në ndryshime.

Neni 11, kam menduar që duhet të jetë neni 10, por duke iu ndryshuar titulli sepse me titullin “Drejtimi i mbledhjes plenare”, kemi edhe nenin 4. Pra edhe neni 4 edhe



neni 11, në draftin e sjellë nga Komisioni, përmbajnë të njëjtin emërtim. Duke qenë se bëhet fjalë për zhvillimin e mbledhjes plenare, kam menduar që ky nen të titullohet “Zhvillimi i mbledhjes plenare” dhe të mos ketë ndryshim në formulimin e tij. Nuk ka asnjë ndryshim, thjesht për të mos pasur dy nene me të njëjtin titull.

Tek neni 11, këtu është ndryshimi (pasi deri tani ka qenë gjuhë teknike legislative) që unë sjell nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës sjell një parashikim të ri që në fakt nuk e kishte as rregullorja e sjellë nga Gjykata e Lartë, nuk e kishte këtë parashikim. E ka futur Komisioni. Komisioni ka parashikuar që: “Para zhvillimit të mbledhjes të jetë kryetari i mbledhjes së përgjithshme që në rast mund të jetë kryetari ose zëvendëskryetari, ai që verifikon përmbushjen e kriterëve të kandidatit dhe përgatit listën”. Në vlerësimin tim, Kryetari i Gjykatës së Lartë apo edhe Zëvendëskryetari nuk mund të ushtrojnë kompetenca vendimmarrëse nëse një kandidat plotëson kushtet apo nuk kandidat nuk plotëson kushtet. Duke qenë se mbledhja e përgjithshme është ajo që e zgjedh kryetarin, autoritetin (mendoj unë) duhet ta ketë mbledhja e përgjithshme. Pra mbledhjes së përgjithshme duhet t’i përcillet lista e kandidatëve dhe dokumentacioni i tyre dhe duhet të jetë ajo që të përcaktojë se cila është lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret për të kandiduar. Sepse në të kundërt ne do të shtojmë një kompetencë të kryetarit dhe zëvendëskryetarit që nuk e kanë në ligj por edhe neni 51 i ligjit në fakt detyrë është që t’i njoftojë/dërgojë anëtarëve listën e kandidatëve që kanë shfaqur interes, jo listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret.

Për këtë arsye, në nenin 11 (ky është një formulim i ri) kam menduar që: 1. Në fillim të mbledhjes së përgjithshme kryetari i saj lexon emrat e kandidatëve dhe prezanton dokumentet që provojnë përmbushjen e kriterëve të kandidimit. 2. Mbledhja e përgjithshme është ajo që verifikon përmbushjen e kriterëve ligjore të kandidimit për secilin kandidat dhe miraton listën përfundimtare me emrat e kandidatëve që i plotësojnë ato. 3. Votimi në këtë rast për përfshirjen e kandidatëve në listën përfundimtare është i hapur (Pra secili voton në mënyrë të hapur për kandidatët që i plotëson kriteret). 4. Lista përfundimtare me emrat e kandidatëve që plotësojnë kriteret miratohet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje (që është shumicë funksionale për mbledhjen, siç e ka edhe ligji). 5. Pas miratimit të listës nga mbledhja e përgjithshme,

secili nga kandidatët paraqet platformën e tij personale. Në vijim, parashikohet edhe faza në të cilën zhvillohet mbledhja.

Pastaj vazhdojmë me Kreun e tretë, nuk ka ndryshime. Tek “Komisioni i votimit”, vetëm tek pika 2 kam parashikuar që: 2. Pasi mbledhja e përgjithshme miraton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore dhe secili prej tyre prezanton platformën përkatëse, drejtuesi i saj lexon emrat e kandidatëve të miratuar dhe i ngre komisionin e votimit (pra ngritja e komisionit të votimit duhet të fillojë pasi mbledhja të ketë miratuar se cilat janë listat e kandidatëve që plotësojnë kriteret). Nuk ka ndryshim fare në formulim më tej.

Neni 13 në fakt titullohet në rregulloren e sjellë nga Komisioni “Rregullat e votimit”, dhe thotë: “1. Përpara fillimit të votimit, komisioni i votimit shpjegon mënyrën dhe rregullat e votimit.”. Në fakt nuk përputhet përmbajtja e nenit me titullin e nenit.

Unë kam marrë disa elementë të nenit 13, 14 dhe 15 të draftit të Komisionit të Karrierës dhe të njëjtat formulime i kam zhvendosur në nenin 13, 14 dhe 15, duke titulluar nenin 13 “Detyrat e komisionit të votimit”, nenin 14 mbetet “Përmbajtja e fletës së votimit” dhe neni 15 “Procesi i votimit”. Të gjitha këto që janë në nenin 14 dhe 15 në fakt janë ndarë në 3 dispozita, duke parashikuar shprehimisht cilat janë detyrat e komisionit të votimit: 1. Komisioni i votimit është përgjegjës për zhvillimin e procedurës së votimit, numërimin e votave dhe shpalljen e rezultatit përfundimtar të votimit. 2. Përpara fillimit të votimit, komisioni i votimit përgatit fletën e votimit, që ne do ta miratojmë sipas formatit bashkëngjitur. 3. Para fillimit të votimit, komisioni i votimit shpjegon mënyrën dhe rregullat e votimit dhe më pas shpërndan fletën e votimit që e ka nënshkruar. 4. Numri i fletëve të votimit të përgatitura nga komisioni i votimit është i barabartë me numrin e gjyqtarëve të pranishëm. Në rast të dëmtimit të fletës së votimit (janë parashikimet që i kemi në rregullore) [...]. 5. Komisioni ndihmohet nga kancelari.

Pastaj është “Përmbajtja e fletës së votimit”: 1. Votimi bëhet duke përdorur fletën e votimit, që e kemi të miratuar. Mënyra se si renditen kandidatët në fletën e votimit, në bazë të rendit alfabetik.

Pastaj neni 15 parashikon vetëm se çfarë përbën procesi i votimit. Kjo është diçka që unë dua ta theksoj. Edhe unë jam i të njëjtit mendim si Komisioni i Zhvillimit të

Karrierës që votimi duhet të jetë i fshehtë dhe individual për përzgjedhjen e kryetarit. 2. Procesi i votimit është i mbyllur dhe rezultati i votimit bëhet menjëherë publik.

Pastaj është e drejta e votimit dhe mënyra se si votohet. Është e njëjta gjë. Nuk ka asnjë ndryshim në formulim, thjesht ka zhvendosje të parashikimeve për ta bërë më të kuptueshëm nenin.

“Pavlefshmëria e votës” dhe “Numërimi i votave” nuk kanë ndryshime. Edhe “Shpallja e rezultatit” nuk ka asnjë ndryshim.

Tek “Njoftimi i vendimit” (e ngrita edhe herën e parë), më duket që ky parashikim që ka sjellë Komisioni që vendimi i mbledhjes t’i përcillet KLGJ-së, Presidentit, Kryetarit, Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese dhe Qendrës së Botimeve Zyrtare për botim në Fletore Zyrtare, është tejkalim ligji vlerësoj unë. Formulimi duhet të jetë që: “1. Vendimi i mbledhjes së përgjithshme për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë përmban rezultatin e votimit, emrin e gjyqtarit që është zgjedhur kryetar dhe datën e fillimit të detyrës. Ky vendim nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët që kanë marrë pjesë në mbledhjen e përgjithshme dhe publikohet në faqen zyrtare internetit (publikimi është i mjaftueshëm). 2. Një kopje e vendimit i përcillet Këshillit të Lartë Gjyqësor (nuk është e nevojshme të publikohet në Fletore Zyrtare).

“Dispozita kalimtare” mbetet e njëjtë sepse kjo dispozitë kalimtare do shërbejë vetëm për zgjedhjen aktualisht të Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Nuk kam asnjë lloj koment. Jam dakord me propozimin.

Neni 22 është ndryshuar, jo “Kjo rregullore”, por “Këto rregulla”, për të ndjekur në uniformitet gjuhën e përdorur, që në fakt jemi në miratimin e një vendimi me disa rregulla.

Për pjesën tjetër jam dakord.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zonja Ukperaj!

Do ftoja anëtarët nëse kanë diskutim.

***Marçela Shehu:*** Po, kisha unë diçka.

***Ilir Rusi:*** Po, zonja Shehu!

***Marçela Shehu:*** Meqenëse ndryshimet e propozuara nga zonja Ukperaj na u prezantuan sot dhe na u relatuan, dhe aktualisht unë kam përpara dy drafte, një që na e ka vënë në dispozicion Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe një draft të ripunuar me sugjerimet e zonjës Ukperaj, unë do doja pak kohë deri në mbledhjen e ardhshme, për t'u njohur dhe për të mbajtur një qëndrim.

Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zonja Shehu!

Ndonjë diskutim tjetër ka?

(Nuk ka diskutime të tjera.)

Atëherë, nisur nga praktika dhe standardi i mbajtur kur një anëtar apo disa të tjerë kërkojnë kohë për t'u njohur me materialet, nisur edhe nga fakti objektiv që na u paraqit përgjatë kësaj mbledhjeje ky draft i ri nga zonja Ukperaj në lidhje me këtë rregullore për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, atëherë, shqyrtimi i kësaj çështjeje do të vijojë në mbledhjet e ardhshme.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 19.07.2023)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të datave: 06.04.2023, 07.04.2023, 14.04.2023, 18.04.2023, 25.04.2023, 26.04.2023, 28.04.2023 (2 mbledhje), 08.05.2023, 11.05.2023, 18.05.2023, 24.05.2023, 25.05.2023, 29.05.2023, 30.05.2023, 05.06.2023, 06.06.2023, 07.06.2023 dhe 14.06.2023.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:11 dhe mbaroi në orën 11:56.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Yllka Rupa</b>     | <b>(anëtare)</b>         |

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Edlira, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.*
- 6. Klodiana Vogli, Specialiste Ligjore, Ambasada Amerikane.*
- 7. Olta Lolo, eksperte pranë EWMI-INL.*
- 8. Valbona Bala, eksperte pranë EWMI-INL.*
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 10. Edmond Hoxhaj (BIRN).*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të datave: 06.04.2023, 07.04.2023, 14.04.2023, 18.04.2023, 25.04.2023, 26.04.2023, 28.04.2023 (2 mbledhje), 08.05.2023, 11.05.2023, 18.05.2023, 24.05.2023, 25.05.2023, 29.05.2023, 30.05.2023, 05.06.2023, 06.06.2023, 07.06.2023 dhe 14.06.2023.

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës, pikën 7, që ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve plenare të datave: 06.04.2023, 07.04.2023, 14.04.2023, 18.04.2023, 25.04.2023, 26.04.2023, 28.04.2023 (2 mbledhje), 08.05.2023, 11.05.2023, 18.05.2023, 24.05.2023, 25.05.2023, 29.05.2023, 30.05.2023, 05.06.2023, 06.06.2023, 07.06.2023 dhe 14.06.2023, me përmbajtjen e të cilave jeni njohur në kohë.

Keni ndonjë diskutim për përmbajtjen e tyre?

*(Nuk ka diskutime).*

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord. (*Vota e zotit Toro nuk dëgjohet në audio, por i kontaktuar nëpërmjet e-mailit ka konfirmuar votën “dakord”. Për efekt të procesverbalit e-maili i konfirmimit të votës i bashkëlidhet procesverbalit të siglosur.*)

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 06.04.2023, 07.04.2023, 14.04.2023, 18.04.2023, 25.04.2023, 26.04.2023, 28.04.2023 (2 mbledhje), 08.05.2023, 11.05.2023, 18.05.2023, 24.05.2023, 25.05.2023, 29.05.2023, 30.05.2023, 05.06.2023, 06.06.2023, 07.06.2023 dhe 14.06.2023.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 19.07.2023)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:11 dhe mbaroi në orën 11:56.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Irena Plaku</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>1</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.



*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Edlira, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.*
- 6. Klodiana Vogli, Specialiste Ligjore, Ambasada Amerikane.*
- 7. Olta Lolo, eksperte pranë EWMI-INL.*
- 8. Valbona Bala, eksperte pranë EWMI-INL.*
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 10. Edmond Hoxhaj (BIRN).*

**RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Çështja e fundit e rendit të ditës lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme. Fjala i jepet relatorit të çështjes z. Kurushi i cili parashtron relacionin e përgatitur lidhur me kërkesën e ardhur nga **Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës**, e cila ka paraqitur një kërkesë për caktimin e tre gjyqtarëve në një çështje penale (lexohen të dhënat e çështjes që do t’i

nënshtrohet procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Gjyqtare {...} ka caktuar masë sigurimi ndaj të pandehurit; gjyqtarët {...}, {...}, {...} kanë gjykuar çështjen e themelit për të bashkëpandehurit. Zoti {...} është përjashtuar nga shorti sipas urdhrit 136, datë 21.02.2023.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë Gjykata Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër (seksioni penal).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 3 (tre).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti Zv/Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, konkretisht: z. Sokol Shehu.

*Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.*

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale (kërkesë e përcjellë me e-mailin e datës 18.07.2023), gjyqtarët Tonin Sterkaj (relator), Arbër Çela dhe Besmir Stroka (anëtarë).

Me përfundimin e shortit, mbledhja deklarohet e mbyllur.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**